

**L I G J**  
**Nr. 9461, datë 21.12.2005**

**PËR NOMENKLATURËN E KOMBINUAR TË MALLRAVE (NK) DHE TARIFËN  
E INTEGRUAR DOGANORE**

*(Ndryshuar me ligjet nr. 9715, datë 16.4.2007; nr. 9982, datë 8.9.2008)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**Neni 1**

*(Ndryshuar togfjalështa në pikën 1 dhe 3 me ligjin nr. 9715, datë 16.4.2007)*

1. Për të pasur një instrument të vetëm, që do të mundësonte administrimin në të njëjtën kohë të tarifës doganore, të statistikave të tregtisë së jashtme dhe të politikave të tjera, që lidhen me mallrat dhe lëvizjen e tyre, Këshilli i Ministrave miraton publikimin zyrtar të nomenklaturës, e cila, nga këtu e më tej, do të quhet Nomenklatura e kombinuar e mallrave (NK).

2. Nomenklatura e kombinuar e mallrave (NK) bazohet plotësisht në Nomenklaturën e Kombinuar të Bashkimit Europian (CN) dhe do të përfshijë:

Nomenklaturën e Sistemit të Harmonizuar (SH) të Organizatës Botërore të Doganave; nënndarjet, që i janë bërë nomenklaturës së SH-së, të quajtura ndryshe edhe “nënkrerë të NM-së”, të cilave u përgjigjet një nivel i caktuar i taksës doganore;

dispozitat paraprake, shënimet shtesë për seksionet, kapitujt dhe shënimet fundore për nënkrerët e NM-së.

3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë botimin e përditësimit të Nomenklaturës së kombinuar të mallrave (NK) me nivelet e tarifave doganore në fuqi, ku të përfshihen edhe nivelet e taksës doganore, kur është e mundur dhe njësitë statistikore plotësuese, si edhe informacione të tjera të nevojshme.

Botimi i miratuar nga Këshilli i Ministrave përfshin nivelet bazë të taksës doganore ose ndryshe ato për kombin më të favorizuar (KMF), sipas përcaktimit të Organizatës Botërore të Tregtisë.

**Neni 1/1**

*(Shtuar me ligjin nr. 9715, datë 16.4.2007)*

Në rastet e bashkimeve të kodeve të nomenklaturës së kombinuar të mallrave me nivele të ndryshme tarifore zbatohet, në çdo rast, niveli më i ulët tarifor, me përjashtim të rasteve kur, me ligj të veçantë, parashikohet ndryshe.

**Neni 2**

*(Ndryshuar togfjalësh në paragrafin e parë me ligjin nr. 9715, datë 16.4.2007)*

Për të mundësuar zbatimin e njëkohshëm të tarifave doganore, të statistikave të tregtisë së jashtme dhe të politikave të ndryshme, në veçanti ato tregtare dhe bujqësore, për importimin dhe eksportimin e mallrave, Këshilli i Ministrave publikon tarifën e integruar të Shqipërisë, që do të

quhet ndryshe dhe “Tarish”.

Tarish-i bazohet në Nomenklaturën e kombinuar të mallrave (NK) dhe përfshin:

- a) nëndarjet shtesë të nëndarjeve të NKM-së, që do të quhen “nënkrrerë të Tarish-it”, të cilat janë të nevojshme për përshkrimin e mallrave, që i nënshtrohen zbatimit të masave të veçanta, të dhëna në nenin 4;
- b) nivelet e taksave doganore dhe të detyrimeve të tjera, që zbatohen në import ose eksport;
- c) kodet numerike, që përmenden në nenin 3 pikat 2 dhe 3;
- ç) nivelet tarifore preferenciale, që zbatohen në importimin ose eksportimin e mallrave të caktuara;
- d) çdo të dhënë tjetër të nevojshme për vënien në jetë dhe administrimin e masave të vendosura në importimin apo eksportimin e mallrave, përfshirë edhe përjashtimet nga taksat.

### Neni 3

Çdo nënkre i NKM-së do të ketë një kod numerik me 8 shifra, ku:

gjashtë shifrat e para janë kodet numerike, që u përkasin krrerëve dhe nënkrrerëve të Nomenklaturës së Sistemit të Harmonizuar;

shifra e shtatë dhe e tetë identifikojnë nënkreun e NKM-së.

Nënkrrerët e Tarish-it do të identifikohen nga shifrat 9 dhe 10, të cilat, së bashku me kodet numerike, të përmendura në pikën 1 të këtij neni, formojnë kodet numerike të Tarish-it.

Në raste përjashtimore, kode të tjera shtesë, përtej nivelit të dhjetë shifrave, mund t’u bashkëlidhen nënkrrerëve të Tarish-it për të zbatuar masa specifike, të cilat nuk janë të koduara ose nuk janë plotësisht të koduara, në nivelin e shifrave 9 apo 10.

### Neni 4

Masa të tjera të veçanta, përveç taksave doganore, që mund të merren për importimin ose eksportimin e mallrave, të përmendura në shkronjën “a” të nenit 2 të këtij ligji dhe që duhet të përfshihen në Tarish, janë:

1. Tatimi mbi vlerën e shtuar;
2. Akciza;
3. Pezullimet tarifore;
4. Kuotat tarifore;
5. Tarifat preferenciale (përfshi kuotat dhe tavanet);
6. Sistemi i përgjithshëm i preferencave tarifore, që zbatohen për vendet në zhvillim;
7. Taksat doganore antidumping dhe ato kundërbalancuese;
8. Taksa të tjera kundërbalancuese;
9. Vlerat për njësi;
10. Çmimet referuese dhe ato minimale;
11. Ndalimet në import;
12. Kufizimet në import;
13. Masa mbikëqyrëse në import;
14. Ndalimet në eksport;
15. Kufizimet në eksport;
16. Masa mbikëqyrëse në eksport;
17. Rimbursimet për eksport.

### Neni 5

*(Ndryshuar togfjalësh në pikën 1 me ligjin nr. 9715, datë 16.4.2007)*

1. Nomenklatura e kombinuar e mallrave (NK), së bashku me nivelet e taksave doganore

dhe detyrimet e tjera, si dhe masat e tjera, të përfshira në Tarish ose në dispozita të tjera ligjore, formojnë tarifën doganore të Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimit të dhënë në nenin 28 të Kodit Doganor dhe që do të zbatohet në importimin e mallrave në Shqipëri.

2. Nomenklatura e kombinuar e mallrave (NK), përfshi kodet numerike dhe, kur është e përshtatshme, edhe njësitë statistikore plotësuese përkatëse, zbatohet për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave të tregtisë me jashtë.

#### Neni 6

1. Tarish-i përdoret nga organet doganore për zbatimin e të gjitha masave, që kanë lidhje me importimin në Republikën e Shqipërisë ose eksportimin nga Republika e Shqipërisë.

2. Kodet e Tarish-it zbatohen në të gjitha importimet e mallrave, që përfshihen në nënkreun përkatës. Kur është e nevojshme ato përdoren edhe në eksportimet e mallrave.

#### Neni 7

*(Ndryshuar togfjalësba në paragrafin e parë, të dytë dhe shtuar paragraf me ligjin nr. 9715, datë 16.4.2007)*

Tarish-i publikohet një herë në vit nga Këshilli i Ministrave. Ai përcaktohet dhe bashkërendohet nga Komiteti për Nomenklaturën e kombinuar Të Mallrave. Tarish-i administrohet dhe shpërndahet, në formë të shkruar dhe elektronike, nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Komiteti për Nomenklaturën e kombinuar e Mallrave, në bashkërendim me Ministrinë e Financave, Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Institutin e Statistikave bashkërendon punën për:

- a) përfshirjen në Tarish të të gjitha masave, që përmenden në nenin 4;
- b) krijimin e kodeve numerike në Tarish, sipas nevojave që do të dalin për zbatimin e masave;
- c) përditësimin e Tarish-it;
- ç) shpërndarjen, menjëherë, në format elektronik, të të gjitha ndryshimeve në Tarish.

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave shërben si sekretari teknike e Komitetit të Nomenklaturës së kombinuar të Mallrave.

#### Neni 8

*(Ndryshuar me ligjin nr. 9715, datë 16.4.2007)*

Komiteti i Nomenklaturës së kombinuar të Mallrave kryesohet nga Ministri i Financave dhe ka në përbërje:

- Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
- Ministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
- Drejtorin e Përgjithshëm të INSTAT-it;
- Kryetarin e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë.

Këshilli i Ministrave miraton rregulloren e funksionimit të këtij komiteti.

#### Neni 9

Komiteti shqyrton çdo kërkesë, që i drejtohet atij nga kryetari, qoftë me nismën e këtij të fundit, qoftë me kërkesë të ndonjërit prej anëtarëve dhe që ka të bëjë me:

- a) Nomenklaturën e kombinuar të mallrave (NK);
- b) Nomenklaturën e Tarish-it dhe çdo nomenklaturë tjetër, të bazuar, tërësisht apo pjesërisht, në Nomenklaturën e kombinuar të mallrave (NK), ose që shton ndonjë nënndarje në të,

për të bërë të mundur zbatimin e masave tarifore ose të masave të tjera, lidhur me tregtinë e mallrave, të vendosura ose që parashikohet të vendosen me ndonjë dispozitë të veçantë.

#### Neni 10

*(Ndryshuar fjalë në shkronjën "a" të pikës 1 dhe fjalia hyrëse e pikës 2 me ligjin nr. 9715, datë 16.4.2007)*

1. Komiteti, në përputhje me procedurën e përshkruar në nenin 11 të këtij ligji, merr të gjitha masat, që i vlerëson të nevojshme, për çështjet si më poshtë:

a) hartimin e Nomenklaturës së kombinuar të mallrave (NK) dhe të Tarish-it, veçanërisht për:

i) klasifikimin e mallrave në nomenklaturën e përmendur në nenin 8 të këtij ligji;  
ii) shënimet shpjeguese;  
iii) krijimin, nëse është i nevojshëm, të nënndarjeve statistikore në Tarish, për t'iu përgjigjur nevojave;

b) përditësimin e Nomenklaturës së kombinuar të mallrave (NK), në përputhje me Nomenklaturën e Kombinuar të Bashkimit Europian;

c) rregullimin e niveleve të taksave, në përputhje me vendimet e marra nga Kuvendi.

2. Hartimi i nomenklaturës bëhet në përputhje me:

a) nivelet e taksave doganore dhe të detyrimeve të tjera, të përcaktuara me ligj;

b) kufizimet sasiore në importimin ose eksportimin e mallrave, të përcaktuara me ligj.

3. Nëse është e nevojshme, duhet të bëhen menjëherë ndryshimet në nënkrerët e Nomenklaturës së kombinuar të mallrave (NK) dhe të Tarish-it. Pavarësisht nga kjo, të gjitha ndryshimet duhet të përfshihen detyrimisht në një botim të vetëm, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji.

#### Neni 11

*(Shfuqizuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 9715, datë 16.4.2007)*

Ministria e interesuar duhet të paraqesë në komitet një projekt të masës, që është në fuqi ose që parashikohet të ndërmerret. Komiteti duhet që, brenda afatit kohor, të formulojë një opinion, të përcaktuar nga kryetari, në përputhje me rëndësinë dhe urgjencën e çështjes. Opinioni duhet të tregojë mënyrën se si duhet të formulohet akti, për t'u bërë e zbatueshme masa që duhet të merret.

#### Neni 12

*(Shtuar togfjalësh në paragrafin e parë, shfuqizuar dhe shtuar paragrafi i dytë dhe i tretë me ligjin nr. 9715, datë 16.4.2007)*

Këshilli i Ministrave, brenda janarit, duhet të miratojë çdo vit një vendim për riprodhimin e versionit të plotë të Nomenklaturës së kombinuar të mallrave (NK), së bashku me nivelet e taksave, në bazë të vendimeve të marra nga Kuvendi për paketën fiskale për vitin pasardhës. Vendimi duhet të botohet në Fletoren Zyrtare jo më vonë se data 15 dhjetor dhe do të fillojë të zbatohet nga 1 janari i vitit pasardhës.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave zhvillon procedurat për riprodhimin e versionit të plotë të Nomenklaturës së kombinuar të mallrave (NK), në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Fondet për riprodhimin dhe procedurat e përcaktuara në paragrafin e dytë të këtij neni mbulohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

#### Neni 13

Ligji nr. 7609, datë 22.9.1992 “Për tarifat doganore”, të ndryshuar, si dhe të gjitha dispozitat e tjera, që bien ndesh me dispozitat e këtij ligji, shfuqizohen.

#### Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2006.

**Shpallur me dekretin nr. 4737, datë 28.12.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë  
Alfred Moisiu**